



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER DRITAN J. GJANA
ADRESA NR.7, NIKOLLA JORGA,
NR.1, NR.2, NR.1
TEL: 0695813188

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 4582

Nr. koleksioni: 1441

Kamez më 31/10/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2022053160159931537



A2022053160159931537

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

(TË SHOQËRISË "EVIA20" SH.P.K)

Sot, më datë 31.10.2022, para meje Noter DRITAN J. GJANA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rr. NIKOLLA JORGA, NR.1, NR.2, u paraqit personalisht:

SHITES:

Ina Doko, atësia Ylli, amësia Felleza, shtetase Shqiptare, lindur në Fier dhe banuese në PATOS, me adresë Taqi Filo 01690002; Nd. 29; H. 1; Zharëz; Zharëz; 9317; Patos, lindur më 20/11/1990, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 037326393 dhe nr. personal J06120025R.

BLERES:

Endrit Doko, atësia Agron, amësia Selime, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në PATOS, me adresë Taqi Filo 01690002; Nd. 29; H. 1; Zharëz; Zharëz; 9317; Patos, lindur më 14/08/1991, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035644659 dhe nr. personal J10814020D.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "EVIA20" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

1. OBJEKTI

1.1 Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi **Ina Doko**, i shet palës blerëse, shtetasit **Endrit Doko, 1 (një)** Kuotë që përbën **100 %** (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të regjistruar të **Shoqërisë "Evia20" sh.p.k** person juridik privat i së drejtës shqiptare, identifikuar me Nr. NIPT (NIUS) M03025401O dhe seli në adresën: Rruga Fier-Zharres, km 10, zk. 3922, nr pasurie 118/24, Fier, Shqipëri.

2. ÇMIMI

2.1 Palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së kuotave të kapitalit të Shoqërisë, të jetë në vlerën totale prej 100.000 (njëqind mijë) lekësh.

2.2 Palët deklarojnë se në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate, çmimi i shitjes së kuotave është likuiduar nga Blerësi, jashtë kësaj zyre noteriale. Palët, Shitësi dhe Blerësi nuk kanë asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm për çmimin e shitjes sipas kësaj Kontrate.

3. MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

3.1 Pronësia mbi 100% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë **"Evia20" sh.p.k**, do të kalojë nga pala shitëse, **Ina Doko**, tek pala blerëse **Endrit Doko** në momentin e depozitimit të kësaj Kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, Tiranë.

3.2 Nga momenti i depozitimit të Kontratës në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pala shitëse, **Ina Doko** humbet çdo të drejtë pronësie mbi **100%** të kapitalit të zotëruar në Shoqëri, dhe këto të drejta fitohen



A2022053160159931537

nga blerësi, i cili nga ky moment bëhet pronar: **Endrit Doko**, të kapitalit të Shoqërisë " **Evia20**" sh.p.k", me strukturën e pjesëve si vijon:

Ortakët e Shoqërisë	Pjesët e Zotëruara	Përqindja e Kapitalit
Endrit Doko	1	100%
Totali	1 kuotë	100%

4.1 Pala shitëse detyrohet:

- T'i kalojë palës blerëse pronësinë mbi kuotat objekt i kësaj kontrate të lirë nga çdo barrë, sekuestrim dhe detyrime të çfarëdolloj natyre.
- T'i dorëzojë palës blerëse dokumentacionin mbi pronësisë e kuotave që i shet nëpërmjet kësaj kontrate.
- Të paguajë shpenzimet e regjistrimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

5. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

5.1 Për këtë Kontratë, do të jenë bazë për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë,
- Legjislacioni që rregullon organizimin dhe funksionimin e shoqërive tregtare;
- Aktet e tjera ligjore që nuk bien në kundërshtim me këtë kontratë.

5.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të shfaqen midis palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin, ekzekutimin, zgjidhjen apo vlefshmërinë e kësaj Kontrate, do të zgjidhen me mirëkuptim mes tyre, në rast të kundërt organi kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. DISPOZITA TË FUNDIT

6.1 Kontrata u përpilua në 5 (pesë) kopje me fuqi të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe, nga një kopje ju jepet palëve, një kopje depozitohet pranë Zyrës Noteriale, një kopje depozitohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), dhe një kopje duhet të depozitohet në selinë e Shoqërisë.

Kontrata, ju lexua me zë të lartë dhe të qartë Palëve, të cilët deklarojnë se e dëgjuan, e kuptuan, dhe të bindur që ajo pasqyron vullnetin e ndërsjellët të tyre e nënshkruajnë atë rregullisht, me vullnet të lirë dhe të plotë.

Unë, Noteri, legalizoj vullnetin e Palëve sipas ligjit.

PALËT

SHITES


Ina Doko



BLERES

Endrit Doko

Em drit Doko



Noter

DRITAN J. GJANA

DRITAN J. GJANA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

**EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË
DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR”**

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	M030254010
2. Data e Regjistrimit	25/06/2020
3. Emri i Subjektit	EVIA20
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	24/06/2020
6. Kohëzgjatja	Nga: 24/06/2020
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Fier ZHAREZ ZHAREZ Rruga Fier-Zharres, km 10, Zona Kadastrale Nr.3922, Numri i pasurise 118/24, Fier, Shqiperi.
8. Kapitali	100.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	Objekti i shoqërisë do të konsistoje në: Tregti me shumicë, pakicë, import-eksport, mirembajtje, montim, shërbim për produkte dhe pajisje për fushën: Elektrike, Elektronike, Industriale, bujqësore, mobilimi, hidrosanitare, lavyerit, kancelari, ndërtim, hidraulike dhe produkte për uejsjellsa, pajisje sigurie dhe kundër zjarrit etj. Laboratore mjeksore, industriale dhe agrokulturale. Mobilim universitete, shkolla, zyra laboratore, spitale, hotele, burgje, porte dhe aeroporte, salla konferencash, teatro, stadium, etj. Tregti me shumicë e pakicë, import-eksport i detergjenteve të pastrimit, reagenteve dhe produkteve ushqimore, tekstile dhe veshje të ndryshme. Organizime eventesh dhe shërbime katering. Për këto qëllime Shoqëria mund të vepronë si në Shqipëri dhe jashtë saj. Kompania gjithashtu mund të vepronë nëpërmjet filialeve të saj apo të shoqërive të kontrolluara prej saj. E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	gjithe kjo ne respektim te legjislacionit qe rregullon ceshtjet specifike te listuara me siper, ndalimet, kufizimet dhe kerkesat ligjore dhe prandaj i nenshtrohen lejeve, autorizimeve dhe regjistrimeve qe mund te jene te nevojshme me perputhje me te gjithe kushtet e tjera. Shoqeria mundet se fundi ne menyre industriale te kryeje cdo veprim tregtar ne lidhje me pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme. Gjithashtu shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter biznesi i cili nuk eshte i ndaluar nga ligji i zbatueshem ne Republiken e Shqiperise.	
10. Administratori/ët	Ina Doko	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 11/11/2020	Deri: 11/11/2025
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	InaDoko	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: EVIA20 E-Mail: inahoxha90@gmail.com	
15. Statusi:	Aktiv	

Lista e Dokumenteve:

Statuti (nese eshte hartuar si dokument i ndryshem nga akti i themelimit)

Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)

Akti i themelimit

Regjistrimi Fillestar: CN-530368-06-20

HISTORIKU I REGJISTRIMIT

Data e	Ndryshimi i te dhenave te regjistruara
--------	--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

regjistrimit	
10/08/2020	<p>Numri i ceshtjes: CN-573655-08-20 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i Vendimit të ortakut të vetëm të shoqërisë, datë 06.08.2020, ku është vendosur: Ndryshimi i kompetencave të administratorit të shoqërisë.</p> <p><u>Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek administratorët:</u> <u>Kane ndryshuar te dhenat per administratorin: ("Olivjo Plepi")</u>, <u>Kompetenca ishte ("Administratori i Shoqerise Z. Olivjo PLEPI, ka te drejte qe te realizoje vetem derdhje ne llogarine bankare te Shoqerise, por nuk ka te drejte te realizoje transferta, terheqje apo cdo lloj veprimi tjeter ne keto llogari. Vetem personi i pajisur me autorizim (prokure te posacme) nga ortaku i vetem i shoqerise Ina HOXHA ka te drejte te realizoje veprime ne llogarite bankare te Shoqerise.") u be ("")</u></p> <p><u>Lista e Dokumenteve:</u> <u>Vendim i asamblese se pergjithshme</u> <u>Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)</u></p>
13/11/2020	<p>Numri i ceshtjes: CN-619169-11-20 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i vendimit të ortakut të vetëm Nr. 2 datë 11.11.2020 per miratimin e largimit të administratorit z. Olivjo Plepi dhe emërimin e administratores znj. Ina Hoxha nga data 11.11.2020 deri më 11.11.2025.</p> <p><u>Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek administratorët:</u> <u>eshte shtuar administratori: ("Ina Doko") Nga data "11/11/2020</u> <u>Ne daten "11/11/2025</u> <u>eshte larguar administratori: ("Olivjo Plepi")</u></p> <p><u>Lista e Dokumenteve:</u> <u>Vendim i asamblese se pergjithshme</u> <u>Dokumenti i autorizimit</u> <u>Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)</u></p>
30/07/2021	<p>Numri i ceshtjes: CN-762447-07-21 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE) Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i pasqyrave financiare te vitit 2020.</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	<p><u>Lista e Dokumenteve:</u> <u>Pasqyra e pozicionit financiar EVIA20 2020.xlsx</u> <u>Shenime Shpjeguese Evia20 2020.pdf</u> <u>Pasqyra e performancës pasqyra e te ardhurave dhe te shpenzimeve sipas natyres EVIA20 2020.xlsx</u> <u>Vendim I Ortakeve Evia20 2020.pdf</u></p>
30/03/2022	<p>Numri i ceshtjes: CN-885095-03-22 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i i aktit per ndryshimin e mbiemrit.</p> <p><u>Lista e Dokumenteve:</u> <u>Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)</u> <u>Vendim i asamblese se pergjithshme</u></p>
09/07/2022	<p>Numri i ceshtjes: CN-946782-07-22 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE) Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i pasqyrave financiare të vitit 2021.</p> <p><u>Lista e Dokumenteve:</u> <u>Pasqyra e pozicionit financiar EVIA20 2021.xlsx</u> <u>Shenimet Shpjeguese Evia20.pdf</u> <u>Pasqyra e performancës pasqyra e te ardhurave dhe te shpenzimeve sipas natyres EVIA20 2021.xlsx</u> <u>Vendimi Asablese - EVIA20.PDF</u></p>

Datë: 31/10/2022

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2022/10/31 14:09:45 +01:00
M03025401O2022103114091947
3006

4

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)

VENDIM
I
ORTAKUT TE VETEM

Nr. 1, datë 29.10.2022

Ortaku i vetëm i Shoqërisë " EVIA20" sh.p.k, **Ina Doko**, atësia Ylli, amësia Felleza, shtetase Shqiptare, lindur në Fier dhe banuese në PATOS, me adresë Taqi Filo 01690002; Nd. 29; H. 1; Zharëz; Zharëz; 9317; Patos, lindur më 20/11/1990, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Leternjoftim ID nr. 037326393 dhe nr. personal J06120025R, zotëruese e 100 % të kapitalit të Shoqërisë zhvilloi mbledhjen e jashtëzakonshme të Asamblesë së Ortakëve me këtë rend dite:

- Dhënien e miratimit për transferimin e Kuotave të Kapitalit të Shoqërisë në favor të personit të tretë .

Në përfundim, pas shqyrtimit të rendit të ditës, mbështetur Statutin e Shoqërisë " EVIA20 " sh.p.k, dhe Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Asambleja e Ortakëve

V E N D O S I

1. Dhënien e miratimit për lejimin e transferimit Kuotave të Kapitalit të Shoqërisë në favor të personit të tretë, sipas skemës së mëposhtme:

- Ortaku i vetëm **Ina Doko** i transferon shtetasit **Endrit Doko**, atësia Agron, amësia Selime, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në PATOS, lindur më 14/08/1991, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Leternjoftim ID nr. 035644659 dhe nr. personal J10814020D, 1 kuotë në pronësi të saj, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të regjistruar të Shoqërisë " EVIA20 " sh.p.k.

2. Pas kryerjes së transferimeve të pronësisë sipas Pikës 1, struktura e pjesëve të Kuotave në Shoqëri do të jetë si vijon:

Ortakët e Shoqërisë	Pjesët e Zotëruara	Përqindja e Kapitalit
Endrit Doko	1	100%
TOTALI	1 Kuota	100 %

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

INA DOKO



REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-20221029112642936
Data e Rezultatit te Kerkimit: 29.10.2022
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 11:26:42AM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-445-2559
Referenca e Perdoriesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

INA YLLI DOKO
EVIA20 SH.P.K.



Handwritten signature: H. Kreni